



Shtatë Luginat

nga

BAHÁ'U'LLÁH-U

Shënim: Ky botim nuk është një përkthim zyrtar dhe mund të ketë gabime. Prandaj, i lutemi miqve që sugjerimet dhe korrigjimet e mundshme t'i dërgojnë me shkrim ose e-mail pranë Sekretarisë së Asamblesë Shpirtërore Kombëtare për Komitetin Bahá'í të Botimeve.

*In the Name of God, the Clement,
the Merciful.*

Praise be to God Who hath made being to come forth ...

And I praise ...

Further, we have hearkened ...

Of this hath the nightingale of oneness sung ...

By my life, o friend ...

Peace be upon him who followth the Right Path!

And further: Stadet që shënojnë udhëtimin e shtegtarit nga banesa e pluhurit për në atdheun qiellor thuhet se janë shtatë. Disa i kanë quajtur këto si Shtatë Lugina dhe të tjerë si Shtatë Qytete. Dhe thonë, se në qoftë se shtegtari nuk shkëputet prej vetes dhe nuk i kalon këto stade, ai nuk do të arrijë kurrë tek oqeani i afërsisë dhe i bashkimit, dhe as ka për të pirë prej verës së pakrahasueshme. Lugina e parë është

LUGINA E KËRKIMIT.

Kali i kësaj luginë është durimi. Pa durim, udhëtari nuk do të arrijë askund dhe asnjë qëllim. Ai kurrë nuk duhet të dëshpërohet; edhe sikur të jetë përpjekur me mijëra vjet dhe akoma mos ta ketë parë bukurinë e Mikut, megjithatë ai nuk duhet të hezitohet dhe as të ndalet. Sepse, ata që janë nisur në kërkim të “Qabes” për “hatrin Tonë” do të gëzohen nga lajmi i mrekullueshëm “Dhe Ne, në rrugët Tona do t’i udhëzojmë ata.”

Në kërkimin e tyre, ata pregatiten me guxim për të shërbyer, dhe në çdo çast përpiqen të kalojnë nga bota e shkujdesjes për në mbretërinë e qënies. Asnjë lidhje nuk i ndal dhe asnjë këshillë nuk i pengon ata.

Këtyre shërbëtorëve i bie për detyrë të pastrojnë zemrën – e cila është burimi i thesareve hyjnore – nga çdo gjë tokësore, të largohen nga imitimi i verbër i brezave të kaluar, t’ia mbyllin derën si miqësisë ashtu edhe armiqësisë

ndaj njerëzve. Në këtë udhëtim, kërkuesi arrin në një stad, nga ku ai i sheh të gjitha sendet e krijuara duke u endur të hutuar në kërkim të Mikut. Ai do të shohë shumë Jakobë që kërkojnë Jozefin e tyre; dhe do të sodisë shumë dashnorë që nxitojnë në kërkimin e të Shumëdashurit. Ai do të dëshmojë një botë me zemra të përmalluara që kërkojnë të Dëshiruarin e tyre.

Në çdo moment ai zbulon një çështje të rëndësishme dhe në çdo orë vihet në dijeni për një mister; pasi zemra e tij është e shkëputur nga të dyja botrat dhe ai është nisur për tek “Qabja” e të Shumëdashurit.

Ndihma prej Mbretërisë së padukshme do t’i jepet atij në çdo hap, dhe nxehtësia e kërkimit të tij do të rritet.

Kërkuesi i vërtetë ndjek vetëm objektin e kërkimit të tij dhe dashnori nuk ka tjetër dëshirë vetëm se bashkimin me të Shumëdashurin e vet. Kërkuesi mund ta arrijë qëllimin e tij vetëm kur të ketë sakrifikuar gjithshka. Kjo do të thotë se ai duhet të braktisë gjithshka që ka parë, që ka dëgjuar dhe që ka kuptuar, ashtu që të mund të hyjë në mbretërinë e shpirtit që është Qyteti i Perëndisë.

Duhet punë e lodhshme për ta kërkuar Atë, dhe zell i madh nevojitet nëse dëshirojmë të pimë mjaltin e ribashkimit; dhe nëse arrijmë të shijojmë këtë kupë me mjaltë, atëhere do ta flakim tutje këtë botë materiale.

Gjatë këtij udhëtimi, shtegtari banon në çdo tokë dhe qëndron në çdo mjedis. Tek çdo fytyrë ai sheh bukurinë e Mikut; në çdo vend ai sheh se mos gjejë të Shumëdashurin. Ai bashkohet me çdo grup dhe kërkon miqësi me çdo shpirt, se ndoshta tek ndonjë mëndje mund të zbulojë sekretin e Mikut ose tek ndonjë fytyrë mund të vështrojë bukurinë e të Dashurit.

Dhe nëse në këtë udhëtim – duke u ndihmuar nga Zoti – ai gjen një gjurmë të Mikut të padukshëm, dhe thith aromën e Jozefit të munguar prej kohësh nga Lajmëtari qiellor, ai do të hyjë menjëherë në Luginën e Dashurisë dhe të shkrihet në zjarrin e dashurisë.

LUGINA E DASHURISË

Qielli i ekstazës është ngritur lart në këtë qytet dhe dielli botë ndriçues i dëshirës së zjarrtë shkëlqen, zjarri i dashurisë është ndezur flakë, dhe aty ku është ndezur zjarri i dashurisë, të korrat e arsyes kthehen në hi.

Në këtë gjëndje udhëtari humbet arsyen dhe çdo gjë veç vetes. Ai nuk sheh as injorancë dhe as dituri, as dyshim dhe as siguri. Ai nuk e dallon dot mëngjezin e udhërefimit nga nata e gabimit. Ai largohet si nga besimi ashtu edhe mosbesimi, ndërsa helmi i vdekshëm, është për të një balsam shërues. Për këtë gjëndje Attari thotë:

Për të pabesin është gabimi – për besnikun është besa;
Për zemrën e Attarit - një atom i dhimbjes tënde.

Kali i kësaj lugine është dhimbja; dhe po të mos ketë dhimbje, ky udhëtim nuk do të mbarojë kurrë. Në këtë shkallëzim, udhëtari nuk ka mendim tjetër veç të Shumëdashurit dhe nuk kërkon strehë tjetër veç Mikut. Në çdo moment ai ofron qindra jetë dhe në çdo hap ai flak mijëra koka tek këmbët e të Dashurit.

O vëllai Im! Për aq kohë sa nuk ke hyrë në Egjiptin e dashurisë, ti s' do ta vështrosh kurrë Jozefin e Bukurisë së Mikut; dhe derisa, ashtu si Jakobi, të mos i kesh braktisur sytë e ty të jashtëm, ti nuk ke për t'i hapur kurrë sytë e qënies tënde të brëndëshme, dhe derisa të digjesh në zjarrin e dashurisë, ti kurrë nuk do të komunikosh me Dashnorin e Përmalluar.

Një dashnor nuk frikësohet nga asgjë dhe asnjë dëm nuk e prek atë. Ti e sheh atë të ftohtë në zjarr dhe të thatë në det.

Një dashnor është i ftohtë në zjarrin e skëterrës;
Dhe një dijetar është i thatë në det.

Dashuria nuk pranon asnjë ekzistencë dhe nuk dëshiron asnjë jetë: Tek vdekja ai sheh jetën dhe tek turpi kërkon lavdinë. Të meritosh çmendurinë e dashurisë duhet të kesh mëndje të kthjellët dhe të meritosh lidhjet me Mikun duhet të jesh i mbushur me shpirt. E bekuar është qafa që është kapur në lakun e Tij, e lumtur është koka që ka rënë në pluhurin e shtegut të dashurisë së Tij. Prandaj, O mik, dorëzoje veten që të gjesh të Pakrahasueshmin, kapërceje këtë tokë të vdekshme që të kërkosh një banesë në çerdhen e qiellit. Përule veten deri në pluhur nëse do të ndezësh zjarrin e qënies dhe të jesh i përshtatshëm për shtegun e dashurisë.

Dashuria nuk mbërthen një shpirt të vdekur,
Dhe një Fajkua nuk gjuan një mi të ngordhur.

Dashuria i vë zjarrin botës në çdo kalim të saj, dhe shkreteton çdo tokë aty ku mban flamurin. Qënia nuk ka asnjë ekzistencë në mbretërinë e tij; i dituri

nuk ka pushtet brënda botës së tij. Levatiani i dashurisë e përpin mjeshtrinë e arsyes dhe e shkatërron zotin e njohurisë. Ai pi shtatë dete dhe prapë etja e zemrës është e pashuar, dhe ai thotë, “ A ka më?” Ai mbyllet në vetvete dhe largohet nga të gjithë që janë mbi tokë.

Dashnori është i huaj si për tokën ashtu edhe për qiellin;
Tek ai ndodhen shtatëdhjetë e dy çmenduritë.

Me mijëra viktima ka lidhur në zinxhirët e tij dhe mijëra dijetarë janë plagosur nga shigjeta e tij. Dijeni se çdo skuqje në botë vjen nga zemërimi i tij dhe çdo zbehtësi në fytyrat e njerëzve është shkaktuar nga helmi i tij. Ai nuk të ofron asnjë ilaç përveç vdekjes, dhe nuk ecën askund veç se në luginën e hijeve, megjithatë, helmi i tij është më i ëmbël se mjalti në buzët e dashnorit, dhe kërkuesi do të pranonte më mirë shkatërrimin e vet se sa mijëra jetë në shkëmbim.

Për këtë arsye, duhen djegur perdet e vetes djallëzore në zjarrin e dashurisë, ashtu që shpirti të mund të pastrohet dhe të mund të njohë shkallëzimin e Zotit të Botrave.

Ndize zjarrin e dashurisë dhe digji të gjitha gjërat,
Pastaj hyr në tokën e dashnorëve.

Dhe nëse konfirmohet prej Krijuesit dhe dashnori i shpëton kthetrave të shqiponjës së dashurisë, atëhere ai do të hyjë në luginën e njohurisë.

LUGINA E NJOHURISË

Në këtë luginë ai del nga dyshimi dhe hyn në siguri, dhe nga errësirra e iluzionit kthehet për tek drita udhërrëfyese e frikës ndaj Zotit. Sytë e tij të brëndëshëm do të hapen dhe ai do të bisedojë vetëm për vetëm me të Shumëdashurin e tij. Ai do të hapë portën e së vërtetës dhe devotshmërisë, dhe do të mbyllë portën e imagjinatave të kota.

Në këtë shkallëzim ai është i kënaqur me dekretin e Zotit. Tek lufta ai sheh paqen, dhe tek vdekja zbulon sekretet e jetës së përjetshme. Me sytë e brëndëshëm dhe të jashtëm, ai dëshmon misteret e ringjalljes në mbretëritë e krijimit dhe të shpirtit njerëzorë. Me një zemër të pastër, ai kupton urtësinë hyjnore në shfaqjet (Manifestimet) e pafundme të Perëndisë. Në oqean ai gjen një pikë dhe tek pika ai vështron sekretet e detit.

Çaje zemrën e atomit dhe ç'të shohësh!
Brënda tij ti do të gjesh një diell.

Në këtë luginë, udhëtari sheh në krijimet e një Zoti të Vërtetë vetëm urtësi të qartë dhe në çdo çast thotë: “Asnjë të metë nuk mund të shohësh në krijimet e Zotit të Mëshirës. Vështro përsëri: A sheh ndonjë të metë?”

Ai sheh drejtësinë tek padrejtësia, dhe tek drejtësia ai sheh mëshirë. Tek injoranca ai zbulon shumë dije të fshehura, dhe tek njohuria ai sheh mijëra urtësi të shfaqura. Ai thyen kafazin e trupit dhe të pasioneve, dhe shoqërohet me njerëzit e mbretërisë së pavdekshme.

Ai ngjit shkallët e së vërtetës së brëndëshme dhe nxiton për në qiellin e domethënies mistike. Ai kalëron mbi urën “dhe do t'i tregojmë atyre shenjat Tonë brënda vetes dhe në horizonte,” dhe udhëton mbi detin “derisa të bëhet e qartë për ta se ky libër është i vërtetë.” Dhe nëse ndeshet me padrejtësinë, ai do të ketë durim, dhe kur takohet me zemërimin, ai do të shfaqë dashuri.

Kjo është gjendja e udhëtarëve në këtë luginë. Mirëpo, njerëzit që ndodhen përmbi këto lugina, e shohin fillimin dhe mbarimin njësoj; përkundrazi, ata nuk shohin as fillim dhe as mbarim, dhe nuk dëshmojnë as “të parë” dhe as “të fundit” Dhe jo vetëm kaq, por banorët e qytetit të pavdekshëm që banojnë në kopshtin e gjelbëruar të shpirtit, nuk shohin madje “as fillim dhe as fund”, ata largohen nga gjithshka që është e para, dhe tërhiqen nga gjithshka që është e fundit. Sepse ata i kanë kapërcyer botrat e emrave dhe i kanë lënë pas vetes botrat e attributeve me shpejtësinë e vetëtimës. Prandaj edhe është thënë: “Uniteti absolut i përjashton të gjitha atributet.” Dhe ata i kanë ndërtuar banesat e tyre në hijen e Esencës. Jo vetëm kaq, por ata janë ngjitur përmbi këtë shkallëzim, dhe prandaj është thënë:

Dashuria është një perde midis dashnorit dhe të dashurit;
Më shumë se kaq, nuk më lejohet t'ju tregoj.

Në këtë orë, mëgjezi i njohurisë ka lindur dhe llampat e kërkimit e të sorollatjes janë shuar.

I mbuluar nga kjo, ishte dhe vetë Moisiu
Edhe pse gjithë forcë e dritë;
Prandaj, ti që s'ke fare krahë,
Mos u përpiq të fluturosh.

Në qoftë se je njeri i komunikimit dhe i lutjes, atëhere ngjitu lart mbi krahët e ndihmës nga Shpirtrat e Shenjtë, ashtu që të mund të vështrosh misteret e Mikut dhe të arrish dritat e të shumëdashurit, “Vërtet, ne vimë nga Zoti dhe tek Ai do të kthehemi.”

LUGINA E UNITETIT

Pasi kalon përmes Luginës së Njohurisë, i cili është plani i fundit i kufizimit, shtegtari vjen tek Lugina e Unitetit dhe pi prej kupës së Absolutes, e sodit mbi Manifestimet e Njësishmërisë. Në këtë luginë ai i përshkon perdet e shumësisë, largohet nga botrat e mishit dhe ngjitet në qiellin e njësisë.

Me veshin e Zotit ai dëgjon dhe me syrin e Tij ai vështron misteret e krijimit hyjnor. Ai hyn në faltoren e Mikut dhe banon në tendën e të Dashurit si një mik i ngushtë. Ai nxjerr dorën e së vërtetës nga mënga e Absolutes dhe zbulon sekretet e pushtetit. Tek vetja nuk sheh as emër, as famë dhe as pozitë, por e sheh veten në lavdërimin e Zotit. Për të, “të gjitha këngët vijnë nga Mbreti,” dhe çdo melodi buron prej Tij. Ai rrin ulur mbi fronin “Thuaj, gjithshka vjen nga Zoti,” dhe pushon mbi qilimin “Nuk ka fuqi e as pushtet veç se tek Zoti.” Ai vështron mbi të gjitha sendet me syrin e njësisë, dhe shikon rrezet ndriçuese të diellit hyjnor të shkëlqejnë nga vënd-agimi i Esencës njësoj mbi të gjitha sendet e krijuara, dhe dritat e njësisë të pasqyrohen në mbarë krijimin.

Për hirësinë tuaj është e qartë se të gjitha ndryshueshmëritë që shtagtari vështron në stadet e udhëtimit të tij në mbretërinë e qënies, burojnë nga vizioni i tij. Për këtë, Ne do të japim një shembull, ashtu që domethënia e saj të bëhet plotësisht e qartë: Merr parasysh diellin e dukshëm; edhe pse ai ndriçon me të njëjtin rrezatim mbi të gjitha sendet, dhe me urdhërin e Mbretit të Manifestimit, dhuron dritë mbi të gjithë krijimin, megjithatë, në çdo vënd bëhet i dukshëm dhe derdh bujarinë e tij në përshtatje me mundësitë e atij vëndi. Për shembull, tek pasqyra ai pasqyron formën dhe rrumbullakësinë e tij, dhe kjo vjen për shkak të ndjeshmërisë së pasqyrës, tek një kristal bën të shfaqet zjarri, dhe tek sendet e tjera shfaq vetëm efektet e ndriçimit të tij, por jo formën e plotë të diskut të tij. Dhe megjithatë, nëpërmjet atij efekti, me urdhërin e Krijuesit, ai stërvit çdo send në përshtatje me cilësinë e atij sendi, ashtu siç e vëren edhe vetë.

Në mënyrë të ngjashme, ngjyrat bëhen të dukshme tek çdo objekt, në përputhje me natyrën e atij objekti. Për shembull, në një sferë të verdhë, rrezet ndriçojnë me ngjyrë të verdhë; tek një e bardhë, rrezet janë të bardha, dhe tek e kuqja, shfaqen rrezet e kuqe.

Pra duket qartë se këto ndryshime vijnë nga objekti dhe jo nga drita që shkëlqen. Dhe nëse një vënd është i mbuluar nga drita, si nga muret apo nga një çati, atëhere ky vënd do të jetë i penguar nga shkëlqimi i dritës dhe dielli nuk do të ndriçojë mbi të.

Kështu ndodh edhe me disa shpirta të paaftë që e kanë mbyllur njohurinë brënda mureve të egos dhe pasionit, dhe e kanë mbuluar atë me retë e injorancës dhe verbërisë, dhe janë të ndarë si me një perde nga drita e diellit mistik dhe misteret e të Shumëdashurit të Përjetshëm. Ata janë larguar shumë nga urtësia e çmuar e Besimit të kulluar të Zotit të Profetëve; janë nxjerrë jashtë faltores së Bukurisë hyjnore dhe janë dëbuar nga Qabja e shkëlqimit. E tillë është vlera e njerëzve të kësaj epoke!

Dhe në qoftë se një bilbil, shkëputet fluturimthi nga kthetrat e egos dhe banon në pjergullën e trandafilishtë të zemrës, dhe nis e tregon misteret e Perëndisë në melodi Arabe dhe këngë të ëmbla Persiane – që edhe një fjalë e vetme do të mjaftonte për t'i dhënë jetë trupave të vdekur dhe për të dhuruar Shpirtin e Shenjtë mbi eshtrat e rrënuara të kësaj ekzistence – ti do të shihje mijëra kthetra ziliqarë e mijëra sqepa të mllefosur, t'i viheshin nga pas dhe të dëshironin me gjithë fuqinë e tyre vdekjen e Tij.

Po, për brumbullin duket e ndyrë aroma e ëmbël, dhe për të sëmurin me ethe, parfumi i këndshëm nuk është asgjë. Prandaj edhe është thënë për udhëzimin e injorantit:

Pastrohu njëherë nga sëmundja e kokës
Dhe pastaj thith frymën e Zotit.

Që ta përmbledhim, tashmë janë bërë të qarta ndryshimet në objekte. Pra, kur udhëtari sodit vetëm mbi vëndin shfaqies – domethënë, kur sheh vetëm sferat shumëngjyrëshe – ai shikon të verdhën, të kuqen dhe të bardhën; prej kësaj vijnë edhe konfliktet midis krijesave, dhe një pluhur errësues që ngrihet prej shpirtave të kufizuar e ka fshehur botën. Disa shohin mbi shkëlqimet e dritës dhe të tjerë kanë pirë nga vera e njësisshmërisë dhe s'shohin gjë tjetër vetëm se vetë diellin.

Për këtë arsye, ata që lëvizin në këto tre plane të ndryshme, i shohin kuptimet dhe fjalët e udhëtarëve si kontradiktore, prandaj edhe është shfaqur vazhdimisht mbi tokë shenja e konfliktit. Ka nga ata që banojnë mbi rrafshin e njësisë dhe që flasin për atë botë, ka të tjerë që banojnë në mbretëritë e kufizimeve dhe disa të tjerë që ndodhen në shkallët e egos, ndërsa një kategori tjetër janë krejtësisht të mbuluar me perde. Kjo është mënyra se si veprojnë njerëzit injorantë të kësaj kohe, të cilët nuk kanë asnjë pjesë nga rrezatimi i Bukurisë hyjnore dhe që pastaj nxjerrin pretendime të ndryshme, dhe që i kanë shkaktuar në çdo cikël dhe epokë, njerëzve të detit të njësisë, atë që meritojnë t'u bjerë mbi kokat e tyre. “Sikur Zoti t'i ndëshkonte njerëzit për gabimet e tyre, atëhere nuk do të ngelte mbi tokë asnjë krijesë! Mirëpo atyre Ai u ka dhënë një afat dhe kur të vijë koha, ai nuk shtyhet më gjatë...”

O Vëllai Im! Një zemër e pastër është si një pasqyrë; pastroje atë me zjarrin e dashurisë dhe të shkëputjes nga gjithshka veç Zotit, ashtu që dielli i së vërtetës të mund të ndriçojë dhe mëngjezi i përjetshëm të agojë. Pastaj, ti do ta shohësh qartë domethënien “Mua nuk më përmban as toka Ime dhe as qielli Im, por vetëm zemra e një shërbëtori besnik më mban Mua.” Dhe do ta marrësh jetën tënde në duart e tua dhe me një dëshirë përmalluese të pafundme do ta dorëzosh para të Shumëdashurit të ri.

Kur drita e Manifestimit të Mbretit të Njësisë ulet mbi fronin e zemrës dhe shpirtit, shkëlqimi i Tij bëhet i dukshëm në çdo gjymtyrë dhe organ. Në atë kohë, vezullon nga errësirra misteri i traditës së famshme: “Një shërbëtor afrohet tek Mua kur Unë i përgjigjem lutjes së tij, dhe kur Unë i përgjigjem lutjes së Tij, atëhere Unë bëhem veshi me të cilin ai dëgjon...”

Në këtë mënyrë, i Zoti i shtëpisë është shfaqur brënda shtëpisë së Tij dhe të gjitha shtyllat e banesës shkëlqejnë nga drita e Tij. Dhe veprimi e efekti i dritës janë nga Dritdhënësi; kështu që të gjithë lëvizin nëpërmjet Tij dhe ngrihen me vullnetin e Tij. Dhe ky është burimi prej të cilit pinë të afërmit e Zotit, ashtu siç është thënë: “Të afërmit e Zotit do të pijnë nga një burim...” Megjithatë, këto fjalë nuk duhen lejuar që të interpretohen sikur Zoti zbret në nivelet e krijesave, pasi duhet ditur se në esencën e Tij, Zoti është i shenjtëruar përmbi ngjitjen dhe zbritjen; Ai ka qenë gjithmonë i lirë nga atributet e krijesave njerëzore, dhe do të vazhdojë të mbesë i tillë përgjithmonë. Asnjëri nuk e ka njohur ndonjëherë Atë; asnjë shpirt s'ka arritur ndonjëherë të gjejë rrugën që të çon për tek Qënia e Tij. Çdo njohës mistik është sorollatur në një udhë pa krye në Luginën e njohurisë së Tij; çdo shenjtë e ka humbur rrugën në përpjekje për të kuptuar Esencën e Tij. I Shenjtëruar është Ai përmbi kuptimin e të urtëve; i lartësuar përmbi njohurinë e dijetarëve! Rruga është e mbyllur dhe

kërkimi ndalohet! Prova e Tij është shenjat e Tij; Qënia e Tij është dëshmia e Tij.

Për këtë arsye, dashnorët e fytyrës së të Shumëdashurit kanë thënë: “O Ti, vetëm Esenca e Tij të tregon rrugën për tek Esenca e Tij, dhe që është i shenjtëruar përmbi çdo ngjashmëri me krijesat e Tij,” E si mundet hiçi i plotë, të ngasë kalin e tij në fushën e paraekzistencës, apo si mundet një hije fluturake të arrije diellin e përjetshëm? Miku (Muhameti) ka thënë, “Po të mos ishte Ti, ne nuk kishim për të njohur Ty,” dhe i Shumëdashuri ka thënë, “dhe as kishim për të arritur prezencën Tënde.”

Mirëpo, këto referime janë bërë për shkallët e diturisë që kanë lidhje me njohurinë mbi Manifestimet e atij Dielli të Realitetit, i cili hedh dritën e Tij mbi Pasqyrat. Shkëlqimi i asaj drite ndodhet në zemra, megjithatë, ky shkëlqim është i fshehur ndën perdet e shqisave dhe konditave të kësaj toke, ashtu si qiriu brënda një feneri prej hekuri, dhe vetëm kur të jetë larguar feneri, vetëm atëhere do të ndriçojë drita e qiriut. Në të njëjtën mënyrë, kur ti të kesh hequr mbulesat e iluzionit nga zemra, vetëm atëhere dritat e njësisë do të bëhen të dukshme.

Pastaj është e qartë se madje edhe për rrezet e dritës nuk ekziston as hyrja dhe as dalja – atëhere ç’duhet thënë për atë Esencë të Qënies dhe për atë Mister kaq të dëshiruar?

O Vëllai Im, udhëto në këto rrafshje me shpirtin e kërkimit dhe jo të imitimit të verbër. Një udhëtar i vërtetë nuk duhet të zbrapset nga kopaçja e fjalëve dhe as të ndalet nga paralajmërimi i iluzioneve.

Si mund të ndajë një perde, dashnorin nga i Dashuri?
As vetë muri i Aleksandrit nuk i ndan ata!

Sekretet janë të shumta, por të panumërt janë të panjohurit. Volume të tëra nuk do mjaftonin për të mbajtur misterin e të Shumëdashurit, dhe as nuk mund të shpjegohet në këto faqe, edhe sikur ky mister të ishte vetëm një fjalë e vetme apo një shenjë e vetme. “Dituria është një pikë e vetme, mirëpo injorantët e kanë shumëfishuar atë.”

Në po të njëjtën mënyrë, mendo për ndryshimet midis botrave. Megjithëse botrat hyjnore janë të pambarimta, megjithatë, disa i janë referuar atyre si katër botra:

1. Bota e Kohës – Zaman. Kjo botë ka si një fillim ashtu edhe një mbarim.
2. Bota e Kohëzgjatjes – Dahër. Kjo botë e ka një fillim, por fundin nuk e ka të shfaqur.
3. Bota e Vazhdimësisë – Sarmad. Fillimi i kësaj bote nuk duket, por që dihet se e ka një fund.
4. Bota e Përjetësisë – Azal. Kjo botë nuk e ka të dukshme as fillimin dhe as mbarimin.

Disa kanë thënë se bota e vazhdimësisë nuk ka as fillim dhe as mbarim, dhe e kanë quajtur botën e përjetësisë si Perandoria e Padukshme dhe e Papushtueshme. Disa të tjerë, i kanë quajtur këto katër botra si:

1. Oborri Qiellor - Lahut
2. Qielli Perandorak - Jabarut
3. Mbretëria e Engjëjve - Malakut
4. Bota e Vdekshme - Nasut

Udhëtimet në shtegun e dashurisë llogariten si katër: Nga krijesat tek Zoti; Nga Zoti tek krijesat; nga krijesat tek krijesat; nga Zoti tek Zoti.

Megjithëse është dhënë një shembull i shkurtër përsa i përket fillimit dhe mbarimit të botës relative dhe të botës së atributive, megjithatë, tani do t'i shtohet një ilustrim i dytë, me qëllim që të jetë e dukshme domethënia e plotë. Për shembull, le të shohë Hirësia juaj veten, ti je i pari në lidhje me djalin tënd, ndërsa i fundit në lidhje me babain tënd. Në pamje të jashtme, ti tregon shfaqien e fuqisë në mbretëritë e krijimit hyjnor; dhe në qënien tënde të brëndëshme, ti zbulon misteret e fshehura të depozituara brënda teje. Kështu që parësia dhe fundësia, e jashtëmja dhe e brëndëshmja, në këtë kuptim janë të vërteta për veten tënde, dhe se në këto katër stade që të janë dhuruar, ti duhet të kuptosh katër gjëndjet hyjnore, ashtu që bilbili i zemrës tënde të thërrasë me zë të lartë mbi degët e trandafilishtes së ekzistencës, qofshin të dukshme apo të padukshme, të vërtetën e shprehjes Kuranore: “Ai është i Pari dhe i Fundit, i Dukshmi dhe i Fshehuri...”

Këto deklarime janë bërë në sferën e asaj e cila është relative për shkak të kufizimeve të njerëzve. Përndryshe, këto personazhe që e kanë kapërcyer me një hap të vetëm botën e relatives dhe të kufizuarës, dhe që banojnë në rrafshin e dëlirë të Absolutes, dhe që i kanë ngritur tendat e tyre në botrat e autoritetit dhe komandës – i kanë djegur me një shkëndijë të vetme këto relativitete dhe i kanë fshirë këto fjalë me një pikë vese. Ata notojnë në detin e shpirtit dhe fluturojnë në atmosferën e shenjtë të dritës. Prandaj, në një plan të

tillë, fjalët nuk kanë ekzistencë, dhe ‘i pari’ dhe ‘i fundit’ apo të tjera si këto, as nuk shihen dhe as nuk përmenden. Në këtë mbretëri, fillimi është vetë fundi, dhe fundi është vetë fillimi.

Me shpirtin e dashurisë ndërto një zjarr
Dhe digji të gjitha, fjalë e mendime.

Tani harroji të gjitha, ashtu që të mund të mësosh nga Mjeshtri i Dashurisë në shkollën e njësisë, dhe të kthehesh tek Zoti e ta braktisësh tokën e brëndëshme të fantazisë në lidhje me shkallëzimin tënd të vërtetë, dhe të banosh në hijen e pemës së njohurisë.

O ti i dashuri im! Varfëroje veten që të mund të hysh në oborrin e lartë të pasurive; dhe përule trupin tënd që të mund të pish nga lumi i lavdisë dhe të arrish kuptimin e plotë të poemave mistike për të cilat ke pyetur.

Kështu është bërë e qartë se këto stade varen nga vizioni i udhëtarit. Në çdo qytet ai vështron një botë, në çdo luginë arrin një burim, në çdo lëndinë dëgjon një këngë. Mirëpo Fajkoi i qiellit mistik ka në gjoksin e Tij shumë këngë të mrekullueshme të shpirtit, dhe zogu Persian mban në shpirtin e Tij shumë melodi të ëmbla Arabe; megjithatë, ato janë të fshehura, dhe të fshehura do të mbesin.

Po të flas, shumë mendje do të shkatërroheshin,
Dhe nëse shkruaj, shumë pena do të thyheshin.

Paqia qoftë mbi atë që e përfundon këtë udhëtim të lartësuar dhe që ndjek Zotin e Vërtetë nëpërmjet dritave të udhërrëfimit!

Shtegtari, pasi i kapërcen planet e larta të këtij udhëtimi hyjnor, hyn në Luginën e Kënaqësisë.

LUGINA E KËNAQËSISË

Në këtë Luginë ai ndjen erërat e kënaqësisë hyjnore të fryejnë nga bota e shpirtit. Ai dëgjet perdet e dëshirës dhe me syrin e jashtëm e të brëndëshëm, vështron brënda dhe jashtë të gjitha sendeve të krijuara, ditën: “Kur Zoti do të shpërblejë secilin nga begatia e Tij.” Nga hidhërimi ai kthehet tek lumturia, nga ankthi në gëzim. Hidhërimi e vajtimi i tij shndërrohen në gëzim dhe hare.

Edhe pse në pamje të jashme, udhëtari në këtë luginë mund të banojë mbi pluhur, megjithatë, nga brënda ata janë ulur mbi fronet e lartësive të domethënies mistike; ata ushqehen prej bujarive të pafundme të kuptimeve të brëndëshme dhe pinë verën e shijshme të shpirtit.

Gjuha nuk mundet t'i përshkruajë këto tre Lugina, dhe e folura është e pafuqishme. Pena nuk hyn dot në këtë zonë dhe boja lë vetëm një njollë të zezë. Në këto rrafsh, bilbili i zemrës ka të tjera këngë e të tjera sekrete, të cilat e bëjnë zemrën të tronditet dhe shpirtin të bërtasë, por ky mister i domethënies së brëndëshme mund të transmetohet vetëm nga zemra në zemër, dhe të besohet vetëm nga gjoksi në gjoks.

Vetëm nga zemra në zemër mund të përcillet lumturia e njohësve mistikë;
Asnjë Lajmëtar nuk mund ta tregojë dhe asnjë letër e shkruar nuk mund ta mbajë.

Unë hesht nga dobësia për këtë temë,
Pasi fjalët e mia nuk mund t'i tregojnë dhe e folura është e pafuqishme

O mik, derisa akoma nuk ke hyrë në kopshtin e këtyre mistereve, ti kurrë nuk do të shijosh verën e pavdekshme të kësaj Lugine. Dhe kur ta shijosh këtë verë, ti do t'i mbyllësh sytë ndaj të gjitha gjërave të tjera dhe do të pish verën e kënaqësisë; dhe do të çlirohesh nga gjithshka tjetër, dhe do të lidhesh ngushtë me Të, dhe do ta sakrifikosh jetën në shtegun e Tij dhe do ta flakësh tutje shpirtin tënd. Sidoqoftë, në këtë sferë ti nuk ke nevojë të harrosh ndokënd, pasi: “Ishte Zoti dhe asgjë tjetër veç Tij.” Sepse në këtë rrafsh udhëtari dëshmon bukurinë e Mikut në çdo gjë. Edhe në zjarr, ai sheh fytyrën e të Shumëdashurit. Tek iluzioni ai vështron sekretin e realitetit, dhe nga atributet, ai lexon enigmën e Esencës. Pasi ai i ka djegur perdet me psherëtimën e tij dhe i ka hequr mbulesat me një shikim të shpejtë; me vështrim depërtues, ai sodit mbi krijimin e ri; me një zemër të kulluar, ai kupton të vërtetat e padukshme. Kjo dëshmohet mjaftueshëm nga shprehja: “Dhe e kemi bërë të mprehtë shikimin tënd në këtë ditë.”

LUGINA E ÇUDISË

Pasi ka udhëtuar përmes niveleve të kënaqësisë së pastër, shtegtari vjen tek Lugina e Çudisë dhe lëkundet në oqeanin e madhësisë, dhe në çdo

moment habia e tij rritet. Tani, ai e sheh formën e pasurisë si vetë varfëria, dhe esencën e lirisë si një pafuqi të plotë.

Tashmë qëndron i shtangur nga bukuria e të Gjithëlavdishmit; dhe pastaj ndjehet i lodhur me jetën e tij. Kjo vorbull e mrekullimit ka shkukur me rrënjë shumë njohës mistikë dhe ka rraskapitur shumë shpirtra. Pasi në këtë Luginë udhëtari flaket në çoroditje, megjithëse, në sytë e atij që ka arritur në këtë luginë, të tilla mrekulli vlerësohen dhe pëlqehen. Në çdo moment ai vështron një botë të mrekullueshme e një krijim të ri, dhe kalon nga habia në habi, dhe mbërthehet nga respekti për veprat e Zotit të Njesisë.

Po të them të vërtetën, O Vëlla, se nëse mendojmë me kujdes për çdo send të krijuar, ne do të dëshmojmë një numër të pafundëm urtësirash të përsosura dhe do të mësojmë të vërteta të panumërta, të reja e të mrekullueshme. Një nga fenomenet e krijuara është ëndrra. Pa shih se sa shumë sekrete janë depozituar, sa shumë urtësira janë ruajtur, sa shumë botra ndodhen të fshehura. Pa mendo pak, si ka mundësi që kur ti je duke fjetur në shtëpi, me dyer të mbyllura; krejt papritur e gjen veten në një qytet të largët, në të cilin ti hyn pa i lëvizur këmbët dhe pa e lodhur trupin; pa përdorur sytë e tu, ti sheh; pa i rënduar veshët, ti dëgjon; pa gjuhë, ti flet. Dhe ndoshta, pasi të kenë kaluar dhjetë vjet, ti do të dëshmosh në botën e jashtme, tamam gjërat që ke parë në ëndërr gjatë asaj nate. Tani, shumë urtësira ka për t'u medituar mbi fenomenin e ëndrrës, të cilat, vetëm njerëzit e kësaj Lugine mund t'i kuptojnë në detaje të vërtetata e saj. Pikë së pari, ç'është kjo botë ku pa sy, vesh, dorë e gjuhë, njeriu i përdor këto të gjitha? E dyta, si ka mundësi që ti sheh në botën e jashtme ngjarjet e një ëndrre, kur ti i ke parë ato dhjetë vjet më parë në botën e gjumit? Mendo pak për ndryshimet midis këtyre dy botëve dhe misteret që ato fshehin, ashtu që të arrish tek konfirmimet hyjnore dhe zbulimet qiellore, dhe të hysh në sferat e shenjtërisë.

Zoti, i Lartësuarit, i ka vendosur këto shenja tek njerëzit me qëllimin që filozofët të mos i mohojnë misteret e jetës së pëtejme dhe as të ulin rëndësinë e premtimeve që ju është bërë atyre. Pasi disa kapen tek arsyeja dhe mohojnë gjithshka që nuk kapet nga mendja, megjithatë, mendjet e dobëta nuk mund t'i kuptojnë kurrë çështjet për të cilat flasim Ne, por ato mund t'i kuptojë vetëm intelijenca Supreme dhe Hyjnore.

Si mundet arsyeja e dobët të përfshijë Kuranin,
Apo merimanga të kapi një feniks në rrjetën e saj?

Të gjitha këto stade mund të dëshmoen vetëm në Luginën e Habitjes, dhe në çdo moment udhëtari kërkon më tepër dhe nuk lodhet aspak. Në këtë mënyrë, Muhameti, Zoti i Fillimit dhe i Mbarimit – duke shpjeguar gradët e përfytyrimit dhe duke shprehur habinë – ka thënë: “O Zot, shtojë çudinë time për Ty.”

Në të njëjtën mënyrë, mendo mbi përsosjen e krijimit të njeriut, dhe se të gjitha këto nivele dhe shkallë, ndodhen të mbështjellura e të fshehura brënda tij.

Mos të duket gjë vetja një formë e parëndësishme
Kur brënda teje ndodhet vetë universi?

Prandaj, ne duhet të punojmë që të shkatërrojmë konditën shtazore, derisa kuptimi i njerëzisë të dalë në dritë.

Kështu edhe LLukmani, i cili kishte pirë nga burimi i urtësisë dhe kishte shijuar prej ujërave të mëshirës, kur po i vërtetonte djalit të tij Natanit rrafshet e ringjalljes dhe të vdekjes, mori si dëshmi dhe si shëmbull fenomenin e ëndrrës. Ne po e tregojmë këtë rast këtu, ashtu që nëpërmjet këtij shërbëtori të përlulur, të mund të qëndrojmë vazhdimisht në kujtesë ai i djalosh i shkollës së Unitetit Hyjnor dhe ai vëlla i artit të udhëzimit dhe Absolutes. Ai tha: “O Biri Im! Nëse nuk mundesh të flesh, ti nuk do të mundesh as të vdesësh. Dhe nëse nuk do mund të çohesh pas gjumit, ti nuk do mund të ngrihesh as pas vdekjes.”

O mik, zemra është shtëpia e mistereve të përjetshme, mos e bëj atë një banesë për fantazitë fluturuese; mos i shpenzo thesaret e jetës tënde të çmuar duke u marrë me këtë botë kalimtare. Ti vjen nga bota e shenjtërisë – mos e lidh zemrën me tokën; ti je një banor në oborrin e afërsisë hyjnore – mos zgjidh pluhurin për banesë.

Si përfundim, nuk ka fund në përshkrimin e këtyre stadeve, mirëpo për shkak të vuajtjeve të shkaktura nga njerëzit e tokës, ky shërbëtor nuk është në gjëndjen e duhur shpirtërore për të vazhduar:

Tregimi ende s’ka mbaruar dhe unë s’kam më dëshirë...
Prandaj, ju lutem të më falni.

Pena rënkon dhe boja derdh lotë, lumi i zemrës rrjedh në valë gjaku.

“Asgjë nuk do të na bjerë neve për fatkeqësi, përveç asaj që na ka caktuar Zoti.”

LUGINA E VARFËRISË SË VËRTETË DHE E VET-FSHIRJES SË PLOTË

y shkallëzim është të vdesësh tek vetja dhe të jetosh tek Zoti. Kjo do të thotë të jesh i varfër në gjërat që i përkasin egos tokësore dhe të jesh i pasur në gjërat e Zotit të dëshiruar. E shprehur më qartë, do të thotë të jesh i ç'veshur nga gjërat e botës materiale dhe të jesh i pasur në gjërat e botës së Zotit. Kur dashnori i vërtetë dhe miku i përkushtuar, arrijnë praninë e të Shumëdashurit, atëhere bukuria rrezëlluese e të Dashurit dhe zjarri i zemrës së dashnorit, ndizen flakë dhe i djegin të gjitha perdet e mbulesat. Po, i digjet gjithshka që ka, nga zemra e deri në lëkurë, dhe asgjë s'do mbesi përveç Mikut.

Cilësitë e të Lashtit të Ditëve u zbuluan,
Atëhere kur cilësitë tokësore Moisiu i dogji.

Ai që e ka arritur këtë shkallë, është i pastruar nga gjithshka që i përket botës. Kjo shprehje e Kuranit duhet menduar thellë, ashtu që të kuptohet gjëndja e këtij shkallëzimi: “Vërtet, të drejtët do të pijnë nga kupa e mbushur në një burim prej Kamfori”- nëse arrihet kuptimi i fjalës “kamfor”, atëhere do të bëhet i dukshëm qëllimi i vërtetë. Pra, nëse ti vjen tek deti i pranisë së Tij, do të shohësh se atje njerëzit nuk zotërohen prej asnjë gjëje të kësaj bote të poshme, qofshin këto pasuri të jashme ose opinione personale. Pasi gjithshka që krijesat kanë është e kufizuar nga kufijtë e tyre, por gjithshka që Zoti ka është e pastruar nga çdo kufizim. Gjëndja e këtij shkallëzimi shprehet me fjalët “Varfëria është Lavdia Ime”. Mirëpo, varfëria e brëndëshme dhe e jashme, ka shumë stade dhe shumë domethënie.

Në këtë shkallëzim, mbështjelljet e çdo sendi shkatërrohen tek gjëndja e udhëtarit mistik, dhe mbi horizontin e përjetësisë, duke dalë nga errësirra, ngrihet madhërishtëm Fytyra Hyjnore. Dhe vetëm atëhere bëhet e dukshme domethënia Kuranore: “Asgjë nuk do të mbesi mbi tokë veç fytyrës së Zotit tënd...”

O Miku im, dëgjoji me zemër këngët e shpirtit dhe ruaji ato si sytë e tu. Sepse urtësitë hyjnore, ashtu si retë pranverore, nuk do t'i dërgojnë përgjithmonë shirat e tyre mbi tokën e zemrës njerëzore; edhe pse hiri i Zotit Bujar-plotë nuk ndalet kurrë, megjithatë, çdo epoke i është caktuar një sasi e veçantë bujarie. Ashtu si thuhet edhe në Kuran : “Tek Ne është e ruajtur çdo gjë, dhe Ne e dërgojmë atë poshtë vetëm sipas një mase të caktuar.”

Retë e mëshirës së të Dashurit bien vetëm mbi kopshtin e shpirtit dhe e dhurojnë këtë bujari vetëm në stinën e pranverës. Stinët e tjera nuk kanë pjesë në këtë hir kaq të madh dhe tokat shterpe nuk marrin asnjë pikë prej këtij favorit.

O Vëlla! Jo çdo det ka perla; jo çdo degë do të lulëzojë, dhe jo çdo bilbil mund të këndojë në të. Prandaj, përpara se bilbili i parajsës mistike të tërhiqet në kopshtin e Zotit, dhe para se rrezet e mëngezitet qiellor të rikthehen tek Dielli i së Vërtetës – bëj pra një përpjekje, se ndoshta, në këtë grusht pluhuri të kësaj bote të vdekshme, do mund të arrish të kapësh një aromë prej kopshtit të përjetshëm, dhe të jetosh përgjithmonë në hijen e njerëzve të këtij qyteti. Dhe kur ta kesh arritur këtë shkallëzim kaq të lartë dhe të vish tek kjo sferë kaq e fuqishme, atëhere ti do ta sodisësh të Dashurin dhe do të harrosh gjithshka tjetër.

I dashuri shkëlqen mbi porta e mure,
Pa asnjë perde, O njerëz të vizionit.

Tashmë, ti e ke braktisur pikën e jetës dhe ke ardhur tek deti i Jetdhënësit. Ky është qëllimi që ti ke kërkuar; dhe në qoftë vullneti i Zotit, atëhere do ta arrish atë.

Në këtë qytet, janë çarë më dysh dhe janë zhdukur edhe vetë perdet e dritës. “Bukuria e Tij nuk ka perde por vetëm Dritë, Fytyra e Tij nuk ka mbulesë por vetëm Zbulesë.” Sa e çuditshme! Ndërsa i Shumëdashuri është i dukshëm si dielli, megjithatë, të shkujdesurit i janë vënë pas shkëlqimit të varakut, i cili mbulon metalet pa vlerë.

Po, kështu është, dendësia e Zbulesës e ka mbuluar Atë, dhe plotësia e Shkëlqimit e ka fshehur Atë.

Si dielli, nditshëm Ai ka shkëlqyer,
Por medet, se në një qytet të verbërish paska ardhur!

Në këtë luginë, udhëtari lë pas vetes statet e “njësisë së Qënies dhe Manifestimit” dhe arrin një njësisshmëri e cila është e shenjtëruar përmbi këto

dy shkallëzime. Vetëm ekstaza mund ta përfshijë këtë temë, jo shqiptimi apo argumenti; dhe ai i cili ka arritur në këtë stad udhëtimiti, apo që ka thithur aromën e kësaj lulishte, e kupton se për çfarë flasim Ne.

Në të gjitha këto udhëtime, shtegtari nuk duhet të shmanget as edhe një fije floku nga “Ligji”, pasi me të vërtetë ky është sekreti i “Rrugës” dhe fruti i Pemës së “Vërtetës”; dhe në të gjitha këto stade, ai duhet të kapet fort mbas rrobës së bindjes ndaj urdhëresave dhe të mbërthejë litarin e largimit nga të gjitha gjërat e ndaluara, ashtu që ai të mund të ushqehet nga kupa e Ligjit dhe të informohet për misteret e së Vërtetës.

Në qoftë se ndonjë nga shqiptimet e këtij shërbëtori nuk mund të kuptohen apo mund të shkaktojë shqetësim, atëhere duhet pyetur përsëri, ashtu që asnjë gjurmë dyshimi të mos mbesë, dhe që domethënia të jetë e qartë si Fytyra e të Shumëdashurit i cili po shkëlqen nga “Shkallëzimi i Lavdishëm”.

Këto udhëtime nuk kanë një mbarim të dukshëm në botën e kohës, por shtegtari i shkëputur – kur konfirmimet e padukshme zbresin mbi të dhe Ruajtësi i Kauzës e ndihmon – mund t’i kapërcejë këto shtatë stade në shtatë hapa, madje në shtatë frymëmarrje, përkundrazi edhe me një frymë të vetme, nëse këtë e dëshiron Zoti. Dhe kjo është nga “Hiri i Tij, të cilën Ai e jep mbi këdo që Ai pëlqen.”

Ata që fluturojnë në qiellin e njësisshmërisë dhe arrijnë detin e Absolutes, e llogarisin këtë qytet – i cili është shkallëzimi i jetës tek Zoti – si stadin më të largët të njohësve mistik dhe si tokën më të skajshme të dashnorëve hyjnor. Mirëpo për këtë Njohës të përlulur të Oqeanit Mistik, ky stad është porta e parë në kështjellën e zemrës, që do të thotë, se është hyrja e parë për tek qyteti i zemrës; dhe zemra është e pajisur me katër stade, të cilat mund t’i tregoj, nëse gjej një shpirt të sjellshëm për të më dëgjuar.

Sapo pena nisi të përshkruaj këtë shkallëzim,
Ajo u thye copash dhe letra u shqye.

O miku Im! Shumë langoj e ndjekin këtë gazelë të shkretëtirës së njësisshmërisë; shumë kthetra duan ta mbërthejnë këtë mëllenjë të kopshtit të përjetshëm. Korbata e pamëshirëshme i kanë zënë pusi këtij zogu të qiejve të Zotit, dhe shumë gjahtarë ziliqarë, dëshirojnë ta kapin në befasi këtë dre të lëndinës së dashurisë.

O Sheik! Me përpjekjen tënde bëj një lllampë, që fatmirësisht, të mund ta mbrosh këtë flakë të Perëndisë prej erërave shkatërruese; megjithëse, kjo dritë kërkon një kohë të gjatë që të ndizet në lllampën e Perëndisë dhe të shkëlqejë në botën e shpirtit. Pasi koka që ngrihet lart prej dashurisë së Zotit, me siguri që do të rrëzohet nga shpata, dhe jeta që është ndezur me përmallim, me siguri që do të sakrifikohet, dhe zemra e cila përkujton të Dashurin, me siguri që do të notojë mbi gjakun e derdhur. Sa bukur është thënë:

Jeto i lirë prej dashurisë, sepse paqia e saj është ankh;
Fillimi i saj është dhimbje, dhe fundi i saj është vdekje.

Mendimet që ti ke shprehur në lidhje me interpretimin e një lloj zogu që në Persisht quhet Gunjishk, u morën parasysh. Duket se je njohës i mirë i të vërtetës mistike. Megjithatë, në çdo nivel dhe për çdo shkronjë, është caktuar një domethënie e cila lidhet me atë nivel. Vërtet, shtegtari zbulon një sekret në çdo emër dhe një mister në çdo shkronjë. Në njërin kuptim, këto shkronja i referohen shenjtërisë.

Pesë shkronjat që përbëjnë këtë fjalë në Persisht janë G, N, SH, K, dhe që janë përkatësisht - Gaf, Nun, Jim, Shin, Kaf.

- 1.** Gaf – i referohet fjalës Kuffi (“I lirë”) që do të thotë, “Çliroje veten nga ajo që pasioni yt e dëshiron dhe pastaj ec përpara drejt Zotit tënd.”
- 2.** Nun – i referohet fjalës Nazzih (“Pastro”) që do të thotë, “Pastroje veten nga gjithshka tjetër përveç Tij, me qëllim që ta dorëzosh jetën tënde në dashurinë e Tij.”
- 3.** Jim – është për fjalën Janib (“Tërhiq”) që do të thotë, “Tërhiq mbrapsht nga Porta e një Zoti të vërtetë, në qoftë se akoma zotëron cilësi tokësore.”
- 4.** Shin – është për fjalën Ushkur (“Falendero”) që do të thotë, “Falenderoje Zotin mbi tokën e Tij dhe Ai të të bekojë ty në qiellin e Tij, edhe pse në botën e njësisë, ky qiell është njësoj si toka e Tij.”
- 5.** Kaf – do të thotë: “Hiqi mbulesat e kufizimeve, që të arrish të mësosh atë që nuk ke ditur për gjëndjet e Shenjtërisë.”

Sikur t’i dëgjoje meloditë e këtij zogu qiellor, ti do të kërkoje për të pirë prej kupës që dhuron pavdeksinë dhe do të refuzoje të pije nga çdo kupë e kësaj bote të vdekshme.

Paqia qoftë mbi ata që ecin në Rrugën e Drejtë!
